

KONTRATË DHURIMI KUOTE

Sot, më datë 28/08/2025, palet nënshkruajnë Kontratë Dhurimi Kuote si më poshtë vijon:

DHURUESI:

Z.Geront Çela, atësia Teki, amësia Metullahe, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, lindur më 14/08/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar pajisur me Pasaporte Nr. Personal G80814092M.

PRANUESI I DHURIMIT:

Z.Bruno Çela, atësia Geront, amësia Merita, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, lindur më 19/05/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. Personal J50519061N.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 761 e vijues i tij; bien dakord dhe hartojnë Kontratën e Dhurimit Pasuri e Luajtshme – kuotë, sipas kushteve dhe kriterëve ligjore të mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Z.Geront Çela dhe Z.Bledar Çela janë ortakë të Shoqërisë "BRUNES CONSTRUACION" sh.p.k, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Identifikimi NUIS K91420001D përkatësisht, Z.Geront Çela zotërues i 80 % të kuotës dhe Z.Bledar Çela zotërues i 20% të kuotës.

Dhuruesi Z.Geront Çela deklaron se dëshiron t'i dhurojë 30% të kuotës që ai zotëron në Shoqërinë "BRUNES CONSTRUCTION" shpk, Pranuesit të Dhurimit Z.Bruno Çela.

Dhuruesi i jep garanci Pranuesit të Dhurimit, për përkatësinë e sendit të dhuruar dhe zhveshjen që ai (sendi) mund të pësojë nga të tretët.

Me lidhjen e kësaj kontrate, Palët marrin dijeni se Dhuruesi, Z.Geront Çela zhvishet nga e drejta e pronësisë mbi 30 % të kuotës që ai zotëron dhe Pranuesi i Dhurimit, Z.Bruno Çela bëhet pronarë me 30% të kuotës në Shoqërinë "BRUNES CONSTRUCTION" sh.p.k.

Pas nënshkrimit të këtij akti, konfigurimi i kuotave të Shoqërisë "Brunes Construction" sh.p.k do të jetë si më poshtë vijon:

Z.Geront Çela zotërues i 50% të kuotës,

Z.Bledar Çela zotërues i 20% të kuotës.

Z.Bruno Çela zotërues i 30% të kuotës.

Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, brenda 30-ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate. Mospërbushja e këtij afati sjell penalitet për çdo ditë vonese.

Urdhërohet Qendra Kombëtare e Biznesit, të bëjë veprimet e nevojshme për kalimin e pjesës takuese të kuotës objekt i kësaj kontrate në emër të Z.Bruno Çela në bazë të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

PALËT KONTRAKTUESE


DHURUESI:

Z.Geront Çela



PRANUESI I DHURIMIT:

Z.Bruno Çela


Bruno Çela